

Republika e Shqiperise
Gjykata e Rrethit Tirane
Nr. 17039 Regj.

17039

VENDIM
Per rregjistrimin e personit juridik

Ne Tirane sot me date *M. L.* 1997 une gjyqtare e gjykates se rrethit Tirane, pasi shqyrtova kerkesen dhe materialet e tjera te paraqitura nga kerkuesi **Petrit Bejko**, banues ne Berat, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar:

KONSTATOVA

Se kerkuesi **Petrit Bejko** ka krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "**Bejko**" sh.p.k. me seli ne Berat ne Lagjen 30 Vjetori (prane stadiumit). Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100000 leke. Administrator i shoqerise eshte vete kerkuesi **Petrit Bejko**. Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet. Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj:

- Servis i automjeteve te transportit rugor.
- Parkim i automjeteve
- Lavazh
- Tregtim me shumice e pakice te pjeseve te kembimit te automjeteve te transportit.
- Kontroll periodik.

Kerkesa e paraqitur nga kerkuesi **Petrit Bejko** per te regjistruar shoqerine si person juridik i krijuar prej tij dhe qe ushtron veprimtarine e mesiperme tregtare eshte nje kerkese e bazuar ne ligj dhe duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe te ligjit 7667 date 28.1 1993

VENDOSA

Pranimin e kerkeses se kerkuesit **Petrit Bejko**.
Regjistrimin si person juridik te shoqerise tregtare "**Bejko**" sh.p.k.
Shoqeria ka ortak te vetem Z. **Petrit Bejko**.

Selia e shoqerise eshte ne Berat ne Lagjen 30 Vjetori (prane stadiumit).

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100000 leke.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet

Administrator i shoqerise eshte **Z. Petrit Bejko.**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Servis i automjeteve te transportit rugor.
- Parkim i automjeteve
- Lavazh
- Tregtim me shumice e pakice te pjeseve te kembimit te automjeteve te transportit.
- Kontroll periodik.

Ⓢ Kunder vendimit lejohet ankim.

Tirane 2.1997

GJYQTARE

Magjane Dede
Sh. Dede

Uradnik registrirani

1. 17039
2. a- Bejko, Sipek
b- Berat, A. "30 Vjetari" "Jurec Stodolnik"
c- Servis avtomobila to transportat
guzor, parkiri, (arazi...)
d- 100 000 lekë
Petrit Bejko.
3. Adam Petrit Bejko, lindur
Berat, banues Berat A 30 Vjetari
4. mbi 10 cet
St 5 flete
k. 2 "
5. 21.02.97
21.02.97.

Gjyptare
Marjana Jecli
(Signature)

Certifikate dt 11/02/1997
B/k Berat.

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“BEJKO”



Une **Petrit Bejko**, lindur ne Berat, dhe banues ne Berat, Lagjja 30 Vjetori me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, duke u bazuar ne legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kryesisht ne ligjin nr 7638 dt. 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare” dhe ne ligjin nr.7667 dt. 29.1.1993 “Per rregjistrin tregtar” me vullnetin tim te lire konkludova ne kete akt themelimi per kushtet qe percaktohen hollesisht me poshte:

1. Krijoj Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “**Bejko**” per te ushtruar aktivitet privat tregtar, ekonomik e financiar ne Republiken e Shqiperise.

2. Selia e shoqerise eshte ne Berat ne Lagjen 30 Vjetori (prane stadiumit). Kjo seli mund te ndryshoje ne rast nevoje, ndersa Shoqeria mund te krijojte filiale, agjensi dhe perfaqesi ne Republiken e Shqiperise.

3. Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100000 leke. Ky kapital eshte i ndare ne 100 kuota me vlere 1000 leke secila

4. Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet, Shperndarja ose pushimi i veprimtarise se shoqerise perpara ketij afati behet vetem ne kushtet e percaktuara nga statuti i shoqerise.

5. Administrator i shoqerise eshte **Z. Petrit Bejko**.

6. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Servis i automjeteve te transportit rugor.
- Parkim i automjeteve
- Lavazh
- Tregtim me shumice e pakice te pjeseve te kembimit te automjeteve te transportit.
- Kontroll periodik.

Shoqeria ne Republiken e Shqiperise gezon te drejtat si cdo person juridik tjeter. Ajo eshte disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj dhe merr persiper te drejta dhe detyrime vetem brenda kufijve te kapitalit te saj. Ortaket mbartin rezikun e veprimtarise se shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit qe kane investuar ne te.

Bejko

7. Shoqeria "Bejko" sh.p.k. ka vulen e vet me inicialet qe percaktohen ne Statutin e saj.

8. Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqerise pasqyrohet ne dokumentacionin kontabel i cili mbahet sipas kriterëve te percaktuara ne organet shtetërore te specializuara.

Bilanci nxiret ne cdo muaj, tremujor dhe ne fund te vitit kalendarik.

9. Fitimi qe realizohet nga veprimtaria periodike e shoqerise i perket ortakut te vetem. Ne cdo rast 5% e fitimit neto vecohet per tu perdorur si fond rezerve per nevojat e ngutshme, kurse 15% investohet per zgjerimin e aktivitetit rentabel te shoqerise.

10. Organet drejtuese te Shoqerise jane:

.Ortaku i vetem

.Administratori

Menyra e funksionimit, kompetencat dhe detyrat e ketyre organeve percaktohen ne Statutin e Shoqerise.

11. Te gjitha aktet shkresore te Shoqerise kane vlere ligjore kur jane te nenshkruara nga Ortaku i vetem dhe kane vulen e shoqerise.

12. Ortaku i vetem eshte i detyruar te zbatoje ligjet ne fuqi, kushtet e ketij akt themelimi dhe te Statutit te shoqerise .

13. Per nevojat e veprimtarise se saj Shoqeria puneson punetore e nepunes duke respektuar kurdohere dispozitat ligjore qe rregullojne problemin e punesimit ne Republiken e Shqiperise dhe duke lidhur kontratat e punes individuale dhe kolektive .

14. Shperndarja e Shoqerise ose pushimi i veprimtarise se saj para afatit si dhe transformimi i saj ne nje lloj tjetër shoqerie mund te behet vetem ne kushtet e percaktuara ne statutin e Shoqerise.

Per problemet qe nuk jane trajtuar shprehimisht ne kete Akt- Themelimi antaret e shoqerise detyrohen ti referohen Statutit te shoqerise dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Akti i Themelimit i shoqerise "Bejko" sh.p.k. perpilohet ne disa kopje, ne gjuhen shqipe dhe i bashkangjitet Statutit te kesaj shoqerie duke u bere pjese integrale e njeri tjetrit.

Ky Akt -Themelimi duke u gjetur ne pajtim me vullnetin e hartuesit qe eshte njekohesisht edhe ortakut i vetem i shoqerise "Bejko" nenshkruhet rregullisht prej tij.

Ortaku themelues i Shoqerise "Bejko" sh.p.k.

Z. Petrit Bejko

Bejko

STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“BEJKO”



Kreu 1

Dispozita te pergjithshme

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **“BEJKO”** themelohet ne perputhje me ligjin nr.7638 dt.19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”:

Kjo shoqeri do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

Shoqeria **“BRJKO”** sh.p.k. eshte person juridik. Ajo e fiton te drejten e personit juridik nga dita e rregjistrimit te saj si e tille ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Ortak i vetem dhe themelues i kesaj shoqerie eshte z.**Petrit Bejko**, lindur ne Berat, banues ne Berat Lagja 30 Vjetori, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Neni 2

Selia e shoqerise

Selia e shoqerise **“BEJKO”** sh.p.k. eshte ne qytetin e Beratit ne Lagjen 30 Vjetori (prane stadiumit)

Shoqeria mund te krijoje dhe hape filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit dhe jashte tij, ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendeve te tjera ku ato mund te hapen.

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet te njepasnjeshem.

Shoqeria mund te pushoje aktivitetin e saj edhe perpara ketij afati sipas kushteve qe parashikon ky statut ne dispozitat e tij dhe sipas kriterëve qe parashikon legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Bejko



Neni 4

Objekti i veprimtarise

- Objekti i veprimtarise se shoqerise "BEJKO" sh.p.k. do te jete:
- Servis i automjeteve te transportit rugor.
 - Parkim i automjeteve
 - Lavazh
 - Tregtim me shumice e pakice te pjeseve te kembimit te automjeteve te transportit.
 - Kontroll periodik.

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve te ortakut te vetem dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Kreu 2

Mardheniet ekonomike dhe financiare

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100000 leke dhe zoterohet teresisht nga ortaku I vetem. Ai ndahet ne 100 kuota me nje vlere prej 1000 leke secila.

Ky kapital derdhet nga ortaku i vetem ne nje nga bankat shqiptare.

Kapitali themeltar i shoqerise ose pjese te caktuara te tij jane te transferueshme kundrejt personave te trete. Transferimi i kapitalit kundrejt te treteve behet kurdohere me akt noterial.


Te gjitha veprimet e shoqerise me kapitalin themeltar behen gjithmone me miratim te ortakut te vetem.

Neni 6

Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen ne nje regjister te vecante.

Neni 7

Bejko

 Fitimi neto i realizuar nga veprimtaria e shoqerise disponohet nga ortaku i vetem.

Neni 8

Shoqeria krijon fondet e veta per zgjerimin e aktivitetit te saj ne perputhje me rregullat ne fuqi
Perberja e fondeve, burimet financiare te tyre caktohen nga ortaku i vetem

Ne cdo rast 5% e fitimit neto vecohet per tu perdorur si fond rezerve per nevoja te ngutshme, kurse 15% e ketij fitimi investohet per zgjerimin e aktivitetit rentabel te shoqerise

Neni 9

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj .
Bilanci nxirret ne cdo muaj, tremujor dhe ne fund te vitit kalendarik.
Bilanci i aktivitetit finciar te shoqerise behet nga ortaku i vetem ose nga nje ekspert i caktuar prej tij.

Kreu 3

Drejtimi dhe administrimi

Neni10

E gjithe veprimtaria e shoqerise drejtohet dhe percaktohet nga ortaku i vetem i shoqerise z.Petrit Bejko.

Neni 11

Ortaku i vetem i shoqerise z.Petrit Bejko eshte edhe administrator i shoqerise.
Per administrimin sa me te mire te saj shoqeria mund te emeruje edhe administratore te tjere.

Neni 12

Ortaku i vetem dhe administratoret e emeruar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e shoqerise pa asnje perjashtim dhe kufizim.

Bejko

Administratori i shoqerise ka te gjitha kopetencat qe te veproje ne emer dhe per llogari te shoqerise ne mardhenie me personat e trete. Shoqeria merr persiper te gjitha pasojat qe mund te vine nga veprimet e administratorit.

Neni 13

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise dhe ndaj personave te trete kur ne veprimet e tij shkel ligjin dhe statutin me faj gjate ushtrimit te veprimtarise si administrator.

Neni 14

Ortaku i vetem i shoqerise vendos per pjesmarjen e shoqerise ne shoqeri te tjera, ndryshon ose ploteson statutin e shoqerise, miraton bilancet vjetore dhe periodike te vleresuara nga organi financiar i shoqerise, vendos per pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, per shtimin e kapitalit te shoqerise dhe per mbylljen e shoqerise.

Neni 15

Ortaku i vetem i shoqerise cakton edhe ekspert kontabel qe te kontrolloje aktivitetin e saj financiar, arken dhe regjistrin e veprimeve kontabel si dhe te pergatise raportin perkates.

Kreu 4

Mardheniet e punesimit

Neni 16

Per nevojat e aktivitetit te saj shoqeria puneson punetore e nepunes. Mardheniet e punes me punonjesit qe do te punesohen rregullohen me kontrata individuale dhe kolektive sipas legjislacionit shqiptar te punes ne fuqi.

Neni 17

Kriteret e pergjitheshme te punesimit te punonjesve, numerin e tyre, kufijte e pageses dhe detyrat e secilit percaktohen nga ortaku i vetem.

Neni 18

Shoqeria respekton rregullat e punesimit dhe te sigurimeve shoqerore, kurse te punesuarit prane kesaj shoqerie jane te detyruar te respektojne dhe te pranojne normat e ketij statuti.

Beyhif

Te punesuarit pergjigjen sipas ligjit dhe sipas ketij statuti per moszbatimin e detyrave dhe per demet qe mund ti shkaktojne shoqerise.



Kreu 5 **Mbyllja e aktivitetit te shoqerise**

Neni 19

Veprimtaria e shoqerise pushon me perfundimin e afatit te percaktuar ne kete statut nese ortaku i vetem nuk e zgjat kete afat. Shoqeria mund te pushoje veprimtarine e saj perpara ketij afati kur per kete vendos ortaku i vetem, ose kur shoqeria falimenton. Ne rastet e mbylljes se aktivitetit te shoqerise kjo e fundit hyn ne procesin e likujdimit te saj.

Neni 20

Veprimtaria e shoqerise pushon edhe ne ato raste kur ortaku i vetem vendos per shnderimin e shoqerise nga sh.p.k. ne ndonje lloj tjeter shoqerie.

Neni 21

Pasuria e shoqerise qe mbetet pas likujdimit te te gjitha detyrimeve qe mund te kete shoqeria i takon plotesisht ortakut te vetem.

Kreu 6 **Dispozita te fundit**

Neni 22

Shoqeria ka vulen e saj ku domosdoshmerisht duhet te jete shkruar emri i shoqerise dhe adresa e selise se saj.

Neni 23

Ndryshimet dhe plotesimet ne kete statut do te behen ne te njejten menyre dhe procedure me te cilen nxiret ky statut .

Ortaku i vetem i shoqerise "BEJKO" sh.p.k. pasi e hartoi kete statut dhe e gjeti konform vullnetit te tij te lire dhe te plote si dhe konform legjislacionit shqiptar ne fuqi e nenshkruan ate pa verejtje.

ORTAKU I VETEM
I
SHOQERISE "BEJKO" SH.P.K.

PETRIT BEJKO

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Bejko".



K E R K E S E

1703P

M. J. Dedi
2.2.1997

Kerkues **Petrit Bejko**, lindur ne Berat, banues ne Berat Lagja 30 Vjetori, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Objekti Kerkohet regjistrimi si person juridik i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"Bejko"**

Baza ligjore ligji 7638 dt.19.11.1992 dhe ligji 7667 dt 29.1.1993

Perpara Gjykates se rrethit Tirane

Une kerkuesi **Petrit Bejko** po i drejtohem gjykates se rrethit Tirane me kete kerkese per te kerkuar rregjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"Bejko"**

Shoqeria ka ortak te vetem Z. **Petrit Bejko**

Selia e shoqerise eshte ne Berat ne Lagjen 30 Vjetori (prane stadiumit)

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100000 leke.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet

Administrator i shoqerise eshte Z.**Petrit Bejko**.

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Servis i automjeteve te transportit rugor.
- Parkim i automjeteve
- Lavazh
- Tregtim me shumice e pakice te pjeseve te kembimit te automjeteve te transportit.
- Kontroll periodik.

Duke qene se shoqeria e krijuar ploteson te gjitha kushtet e nevojshme per zhvillim normal te veprimtarise se saj dhe i pergjigjet kushteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi shpresojme se gjykata do te pranoje kerkesen e mesiperme.

Bejko regjistruar
Kuvener
dt. 2.2.1997.
B. Y. Dedi
M. J. Dedi
ANALIZOY

**Me respekt
Petrit Bejko**

Bejko